



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry  
Kabineti i Ministrisë-Kabinet Ministra-Cabinet of the Minister

01.Ref. Nr.01  
Prishtinë, 18.06.2020

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), në mbështetje të neneve 10, 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 8 pikat 20, 30 e 31 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke pasur parasysh kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit, rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19, nxjerr këtë:

### URDHËRESË

Për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në sektorin e gastronomisë

1. Urdhërohen të gjithë operatorët ekonomikë të sektorit të gastronomisë që sipas kësaj urdhërese të marrin këto masa higjienike dhe parandaluese:
  - 1.1. Distanca nga ulësja në ulësen prapa shpinës, jo më shumë se 1.5 metra.
  - 1.2. Distanca në mes të ulëseve brenda tavolinës të jetë së paku 1 metër.
  - 1.3. Të mos ulen më shumë se 4 persona në një tavolinë, përveç nëse janë anëtarë të së njëjtës bashkësi familjare.
  - 1.4. Të ketë dezinfektantë të qashtëm lehtë nga klientët në çdo lokal.
  - 1.5. Stafi të jetë i pajisur me maska mbrojtëse.
  - 1.6. Të mos shërbehet në banak.
  - 1.7. Servisimi i tavolinave (vendosja e thikave, pirunëve, lugëve, etj.) të bëhet bashkë me shërbimin e porosisë.
  - 1.8. Menyja të jetë për një përdorim ose të jetë e tillë që të mund të dezinfektohet pas çdo porosie.
  - 1.9. Të bëjë dezinfektimin dhe ajrosjen e rregullt të lokaleve dhe hapësirave të punës.
  - 1.10. Të publikohet në çdo lokal manuali për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19 i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Veseli KRASNIQI

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrisë së MTI-së
- Zyrës së Kryeministrit
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Inspektoratit të Tregut